

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Alban Beqiri, kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët porotë Asllan Zariqi dhe Nazmi Behluli, në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj me vendqëndrim në shtetin e [REDACTED] për ndryshimin e aktgjykimit C.nr.496/05 dt.03.03.2006 në lidhje me besimin e fëmijëve, pas shqyrtimit kryesor më dt.03.08.2015 në prezencën e paditëses, të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesë padia e paditëses [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë C.nr.496/05 dt.03.03.2006, në paragrafin 2 të dispozitivit ashtu që tani fëmijët [REDACTED] i lindur me datë [REDACTED], [REDACTED] i lindur me datë [REDACTED] dhe [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED] i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim babait [REDACTED]
- II. **DETYROHET** paditësja [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj që t'ia dorëzoi fëmijët e mitur [REDACTED] dhe [REDACTED], të paditurit [REDACTED] në ruajtje, mbajtje dhe edukim brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi
- III. Pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pa ndryshuar.
- IV. Aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm në ditën e shpalljes me dt.03.08.2015, pasi që palët kanë hequr dorë nga drejta e ankesës.

Secila palë i heq shpenzimet e veta të procedurës.

Ar sy e t i m i

Paditësja në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se me te paditurin kemi qenë të martuar nga e cila martesë kemi lindur tre fëmijë dhe atë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kurse jemi shkurorezuar me aktgjykimin e Gjykatës se Qarkut ne Prishtine C.nr.496/05 dt.03.03.2006, sipas paragrafit 2 te këtij aktgjykimi fëmijët e mitur mu janë besuar ne ruajtje, edukim dhe mbajtje paditëses-nënës [REDAKTUAR].

Me qenë se nga koha kur jemi shkurorezuar e deri më tani kanë ndryshuar kushtet ekonomike në favor të paditurit, pasi që jam e papunë dhe nuk mundem që tani për tani ti përballoj shpenzimet për ushqimin, veshmbathjen për fëmijët.

I padituri është me punë të përkohshme në shtetin e [REDAKTUAR] që është i punësuar dhe ka kushte ekonomike më të mira dhe stabile, dhe prej momentit te marrjes se aktgjykimit te Gjykatës se Qarkut ne Prishtine e deri me tani kane ndryshuar rrethanat ashtu qe ne ketë faze do te ishte ne interesin e fëmijëve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], ti besohen ne ruajtje, kujdes dhe edukim babait – të paditurit, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e paditëses.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I padituri nuk e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses lidhur me ndryshimin e aktgjykimit për fëmijët [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe ka theksuar se është e vërtet se kanë ndryshuar rrethanat prej momentit te marrjes se aktgjykimit te Gjykatës se Qarkut ne Prishtine lidhur me ruajtje, mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve ne favor të paditurit.

Meqenëse punoj në shtetin e [REDAKTUAR] dhe kamë kontratë të rregullt të punës dhe të hyrat e mia financiare janë stabile dhe rrethanat ekonomike nga koha e zgjidhjes së martesës me paditësen deri më tani kanë ndryshuar në favor timin.

Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës

Për kundër faktit të mos kontestimit të kërkesë padisë nga ana e të paditurit, gjykata dëgjoji fëmijët e mitur dhe atë:

██████████ i lindur me datën ██████████ i cili ka deklaruar se e ka ndërprerë shkollimin dhe atë në klasë të XI për shkak se në këtë periudhë kamë qenë duke e vazhduar kursin për njohjen e gjuhës Gjermane në Ferizaj bashkëjetoj me nënën ██████████ mirë po për shkak se nëna nuk punon dhe kemi kushte të vështira ekonomike dëshiroj që tani e tutje te jem nën përkujdesjen, edukimin dhe mbajtjen nga ana e prindit tim ██████████ i cili jeton ne ██████████ për shkak te ndryshimit të rrethanave te cilat kanë ndodhur nga koha e zgjidhjes se martesës se prindërve te mi e deri me tani, si deh faktin se prindi im ka shpreh dëshirë që të jem nën përkujdesjen e tij të cilën gjë nuk e kundërshtoj as unë.

██████████ i lindur me dt ██████████ i cili ka deklaruar: se është nxënës i klasës se X, në shkollën e mesme “Zenel Hajdini” ne Ferizaj deri me tani bashkëjetoj me nënën time ██████████ i mirë po për shkak se kemi kushte të vështira ekonomike dëshiroj që tani e tutje te jem nën përkujdesjen, edukimin dhe mbajtjen nga ana e prindit tim ██████████ i cili jeton ne ██████████ për shkak te ndryshimit të rrethanave te cilat kanë ndodhur nga koha e zgjidhjes se martesës se prindërve te mi e deri me tani, si deh faktin se prindi im ka shpreh dëshirë që të jem nën përkujdesjen e tij të cilën gjë nuk e kundërshtoj as unë.

██████████ i lindur me datën ██████████ i cili ka deklaruar: se është nxënës i shkollës fillore në fshatin ██████████ Komuna Ferizaj deri me tani bashkëjetoj me nënën time ██████████ mirë po për shkak se kemi kushte të vështira ekonomike dëshiroj që tani e tutje te jem nën përkujdesjen, edukimin dhe mbajtjen nga ana e prindit tim ██████████ i cili jeton ne ██████████ për shkak te ndryshimit të rrethanave te cilat kanë ndodhur nga koha e zgjidhjes se martesës se prindërve te mi e deri me tani, si deh faktin se prindi im ka shpreh dëshirë që të jem nën përkujdesjen e tij të cilën gjë nuk e kundërshtoj as unë.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: U lexua padia e dt.26.12.2014, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë C.nr.496/05 dt.03.03.2006, certifikata e lindjes për ██████████ me numër rendor ██████████ me numër të referencës ██████████ dt.20.05.2013,

certifikata e lindjes për [REDAKTUAR] me numër rendor [REDAKTUAR] nr. Referencës [REDAKTUAR] dt.24.12.2014, ekstrakti i lindjes për [REDAKTUAR] me numër serik [REDAKTUAR] dt.08.12.2014, ekstrakti i lindjes për [REDAKTUAR] me numër serik [REDAKTUAR] dt.08.12.2014, ekstrakti i lindjes për [REDAKTUAR] me numër serik [REDAKTUAR] dt.08.12.2014, deklarata e bashkësisë familjare me numër serik [REDAKTUAR] dt.24.12.2014, ekstrakti i lindjes për [REDAKTUAR] me numër serik [REDAKTUAR] dt.24.12.2014, raporti për besimin e fëmijëve të mitur i ërpiluar nga Qendra për Punë Sociale Ferizaj me numër 25-5415 dt.10.06.2015.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqjese dhe provave të nxjerrura, në kuptim të Nenit 8 të LPK me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Gjykata me rastin e vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, konsideron se e njëjta bazohet në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, mendimi i dhënë nga ana e Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj me numër 25-5415 dt.10.06.2015, në veçanti pohimin nga ana e të paditurit dhe vullnetin e tij që të kujdeset për fëmijët e mitur në të ardhmen.

Gjykata me nxjerrjen e provës së aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë C.nr.496/05 dt.03.03.2006, dhe çertifikatat e lindjes për fëmijët e mitur, Ekstrakti i lindjes për [REDAKTUAR] me numër serik [REDAKTUAR] dt.08.12.2014, ekstrakti i lindjes për [REDAKTUAR] me numër serik [REDAKTUAR] dt.08.12.2014, ekstrakti i lindjes për [REDAKTUAR] me numër serik [REDAKTUAR] dt.08.12.2014, me të cila prova është vërtetuar se paditësja me të paditurin kanë qenë në bashkësi martesore prej datës 16.10.1996 deri ma datën 03.03.2006, nga kjo martesë kanë lindur fëmijët [REDAKTUAR] i lindur me datën [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] i lindur me datën [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] i lindur me datën [REDAKTUAR]

Këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe përmes thënieve të palëve ndërgjyqjese në seancë të shqyrtimit kryesor, i padituri ka deklaruar se me rastin e zgjidhjes së martesës me paditësen fëmijët e mitur më janë besuar mua në përkujdesje, edukim, dhe ruajtje, kurse nga ajo kohë deri më tani kanë ndryshuar rrethanat në favor të paditurit dhe ka shprehur dëshirë që me qenëse rrethanat kanë ndryshuar fëmijët e mitur ti besohen si prind në ruajtje, kujdes dhe edukim dhe tre fëmijët e mitur këtë vendim lidhur me ndryshimin e aktgjykimit nuk e kanë kundërshtuar dhe të njëjtit janë pajtuar që tani e tutje të jenë nën ruajtje, kujdes dhe edukimin e prindit

Për ta vërtetuar këtë gjendje faktike gjykata ka kërkuar edhe nga ana e Qendrës për Punë dhe Mirëqenie Sociale një mendim profesional si organ kompetent lidhur me kërkesën e paditëses për ndryshimin e aktgjykimit sa i përket besimit të fëmijëve, ku në mendimin e tyre të dhënë me shkrim të cilët e kanë dorëzuar në gjykatë me datën 11.06.2015 ku kanë vlerësuar se fëmijët e mitur duhet ti besohen prindit [REDAKTUAR] të njëjtin e ka e ka vlerësuar si objektiv dhe profesional.

Këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe me dëgjimin e fëmijëve të mitur të cilën pas ndryshimit të këtyre rrethanave kërkojnë që tani e tutje të jenë nën përkujdesjen e prindit të tyre [REDAKTUAR] i cili jeton në shtetin e [REDAKTUAR], me arsyetim se nëna nuk punon dhe për shkak të kushteve ekonomike të varfra që mbizotërojnë në familje dhe se vullnetin e prindit që të kujdeset në ruajtje, edukim që tani e tutje të kujdeset për fëmijët e mitur

Për këto arsye të cekura më lart gjykata ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore dhe ka vendosur në bazë të nenit 139 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Meqenëse asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjykata vendosi që secila palë ti heqë shpenzimet e veta.

Pas komunikimit të aktgjykimit, palët kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta e ankesës, andaj ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm ditën e shpalljes me dt. 04.11.2013.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.829/14 më datë 03.08.2015



Kryetari i trupit gjykues,

Alban Beqiri